




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 125/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković– Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik konzorciumi Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr’’Alba Clean’’ –me seli në Gjermani, kundër njoftimit/vendimit të AK-së, të datës 07.03.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Kërkesë për Propozim për PPP për Parkingun Nëntokësor në Prishtinë” me nr.prokurimi 616-18-072-512, iniciuar nga autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë, më datën 24.04.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e grupit të operatoreve ekonomik konzorciumi “Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr’’Alba Clean’’ –me seli në Gjermani, kundër njoftimit për eliminim në fazën e vlerësimit teknik të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Kërkesë për Propozim për PPP për Parkingun Nëntokësor në Prishtinë” me nr.prokurimi 616-18-072-512, iniciuar nga autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë.

II. **ANULOHET**, njoftimi/vendimi i autoritetit kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë, i datës: 07.03.2019, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Kërkesë për Propozim për PPP për Parkingun Nëntokësor në Prishtinë” me nr.prokurimi 616-18-072-512, dhe anulohet në tersi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nëse edhe me tutje autoriteti kontraktues ka interes për të vazhduar me këtë aktivitet të prokurimit të njëjtin mund ta ritenderoj konform dispozitave të LPP-së.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatoreve ekonomik konzorciumi Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr''Alba Clean'' –me seli në Gjermani, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e Njoftimi të kërkesës për kualifikim është bërë me dt: 19.06.2018.

Hapja e ofertave për kualifikim është bërë me dt: 24.07.2018.

Data e Njoftimi me email për tenderues të eliminuar është bërë me dt: 07.03.2019.

Data e Njoftimi për dhënien e kontratës është bërë me dt: 17.01.2019.

Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 12.03.2019.

Data e vendimit të AK-së, lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 15.03.2019.

Grupi i operatoreve ekonomik konzorciumi Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr''Alba Clean'' –me seli në Gjermani, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 22.03.2019 me nr. 125/19, kundër njoftimit për eliminim në fazën e vlerësimit teknik të ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Kërkesë për Propozim për PPP për Parkingun Nëntokësor në Prishtinë" me nr. prokurimi616-18-072-512, iniciuar nga autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 54, 59, 65, 72, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 27, 29,39,41,43 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, si dhe ligjin 04/L-045 për Partneritet Publik Privat.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së, me datë: 29.03.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues/teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertin shqyrtues/teknik në raportin e dt: 08.04.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim: Lidhur me pretendimin e OE ankues,se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Neni 6 të LPP-së (Ekonomiciteti dhe efikasiteti) saktësisht paragrafit 1 të këtij neni kur ka eliminuar ofertën tonë padrejtësisht dhe tani ka mbete vetëm një ofertë e përgjegjshme dhe nuk ka konkurrencë të mirëfilltë financiare, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eliminimi i një oferte si të pa përgjegjshme dhe mbetja e vetëm një oferte të përgjegjshme nuk është në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së. Sipas dispozitave të këtij neni, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Meqenëse në rastin e tanishëm oferta financiare nuk është hapur ende dhe nuk dihet sa është vlere, atëherë nuk dihet a është ekonomike apo jo. Prandaj deri në këtë fazë nuk ka shkelje të nenit 6 të LPP-së. Për krijimin e konkurrencës është e nevojshme në këtë procedurë numri i mjaftueshëm i ofertuesve, mirëpo ata gjithsesi duhet ti plotësojnë kushtet dhe kriteret e dokumentit tenderik për të kaluar këtë fazë. Nuk mundet të pranohet oferta e pa përgjegjshme vetëm për të krijuar konkurrencën. Ky pretendim ankimor i OE ankues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të Neni 7 të LPP-së (Barazia në trajtim/jo diskriminimi) sepse oferta jonë nuk është trajtuar njëjtë si e konzorciumit tjetër sepse komisioni vlerësues është kapur në elemente mjaftë të thjeshta të projektit tonë, ndërsa projektit të konzorciumit tjetër i mungojnë mjaft detaje të tilla dhe është shpallë i përgjegjshëm në aspektin teknik, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eliminimi i operatorit ekonomik ankues është bërë për mos plotësim të një kërkesë obligative të dosjes së tenderit për dokumentacionin teknik të projektit. Sipas komisionit vlerësues, OE ankues nuk ka prezantuar fare dokumentet pjesa (d)Përmbajtja e projektit, respektivisht pika7 e “Detajeve karakteristike arkitektonike”.Sipas pikës VI.3.2 Vlerësimi i propozimeve teknike të dokumentacionit tenderik thuhet:

“Komisioni i Vlerësimit rezervon të drejtën të refuzojë çdo propozim teknik i cili konsiderohet objektivisht të jetë i paarsyeshëm ose i pa-zbatueshëm.

Propozimet teknike që konsiderohen të papranueshme, duke mos i plotësuar kushtet minimale teknike, do të refuzohen, pa shqyrtim të mëtejshëm. Propozimi financiar i ofertave që kanë dështuar për të marrë një rezultat kalues për Propozimin Teknik do të mbeten të mbyllura”.

Bazuar në këto dispozitat të dokumentit tenderues për mendimin e ekspertit shqyrtues, komisioni i vlerësimit teknik të ofertave ka pasur të drejtë të eliminoj një ofertë që nuk i ka përmbushur kushtet minimale. Në rastin konkret eliminimi është bërë për shkak të mos plotësimit të pikës së theksuar më lartë“Detajeve karakteristike arkitektonike”. Pra nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues ka respektuar dispozitat e dhëna në dokumentin tenderues.

Vlerësimi i propozimeve teknike është bërë mbi bazën e kriterëve të dhëna në dokumentin tenderues për të dy ofertuesit. Pretendimi i OE ankues se propozimit teknik të OE të përgjegjshëm i mungojnë mjaftë detaje (pa i përmendur cilat janë ato), nuk munden të shqyrtohen nga eksperti i prokurimit. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së(Njoftimi i kandidatëve dhe tenderuesve të eliminuar) dhe nenit 43 të RRUOPP sepse neve na ka njoftuar për eliminim vetëm me e-mail, ndërsa është dashur të përdorë Letrën Standarde për tenderuesit e eliminuar, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Është fakt se njoftimi i OE ankues për eliminim është bërë përmes e-mailit dhe jo me formularë standard të miratuar nga KRPP (B42). Si rregulle ky formularë duhet të përdoret nga autoritetet kontraktuese me rastin e njoftimit të tenderuesve. Megjithatë edhe informimi përmes e-mailit ka paraqitë arsyet e eliminimit të OE ankues. Kjo mënyrë e njoftimit të operatorit ekonomik ankues nuk e ka dëmtuar atësi edhe nuk ka ndikuar në procesin e prokurimit. Si do që të jetë eksperti shqyrtues e vlerëson këtë pretendim ankimor pjesërisht të bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) dhe nenit 39 të RRUOPP sepse nuk ka kërkuar sqarime shtesë ku përmes sqarimit shumë lehtë ka mundur të sqaroj detajet teknike arkitektonike dhe jo të eliminohej, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Sipas nenit 72 pika 2 e LPP-së thuhet se, autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësoj certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.

Në rastin konkret autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin ekonomik për detajet karakteristike arkitektonike të projektit të cilat nuk janë punuar sipas kërkesës të dokumentit tenderik. Pra pjesa e

projektit për të cilën është eliminuar OE ankues nuk përfshihet në kuadër të dokumenteve të parapara në nenet 65-71 të LPP-së. Po ashtu kjo pjesë e projektit nuk mundet të plotësohet pas dorëzimit të ofertës sepse mbi ndesh me pikën 3 të nenit 72. Nuk kemi të bëjmë shkelje të nenit 72 të LPP-së, siç pretendohet. Pra edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se autoriteti ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe neneve 29,41 dhe 27 të RRUOPP sepse OE ankues ka ofruar sigurimin e tenderit me afate 125 ditë e që duhet të jetë 150 ditë, po ashtu në emër të konzorciumit fitues ka nënshkruar i njëjti person "GuidoStefanelli" dokumentet në emër të dy kompanive që janë pjesë e këtij konzorciumi, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në dokumentin tenderues (KPP) pika IV.7 Sigurimi i tenderit ceket:

"Ofertuesi do të kërkohet që të vendosë sigurimin e parevokueshëm dhe pa kushte të tenderit në shumën prej 200,000.00 € (dyqind mijë Euro) ("Sigurimi i Tenderit") për kohëzgjatjen e periudhës së vlefshmërisë të tenderit, siç është përcaktuar në nenin IV.11 të këtij dokumenti". Gjithashtu kjo është sqaruar edhe në sqarimet shtesë #4 të AK-së.

Po ashtu pjesë e dokumentit tenderues (KPP) është edhe Formulari 3.A.2 – Formulari i Sigurimit të Tenderiti cili në një dispozitë të tije thotë:

"Kjo garanci është në fuqi nga data e këtij ligji dhe do të mbeten në fuqi të plotë deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës"

Mbi bazën e kërkesës për sigurimin e tenderit të dhënë nga autoriteti kontraktues në dokumentin tenderues (KPP), atëherë edhe konzorciumi i shpallur si i përgjegjshëm e ka ofruar sigurimin e ofertës në përputhje me kërkesën, respektivisht 5 ditë më të gjatë se kërkesa. Prandaj kjo është në rregulle sepse kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë e tillë.

Sa i përket pjesës tjetër të këtij pretendimi se personi i njëjtë ka nënshkruar dokumentet për të dy kompanitë të cilat janë pjesë e një konzorciumi, kjo nuk bën shkelje të LPP-së sepse të dy kompanitë kanë dorëzuar një ofertë në emër të një konzorciumi. Personi në fjalë, nënshkruar i dokumenteve është përfaqësues zyrtar i dy kompanive. Po ashtu kompanitë kanë nënshkruar deklaratat për marrje pjesë në këtë konzorcium në përputhje me nenin 27 të RRUOPP. Të gjitha këto pjesë, të këtij pretendimi ankimor janë në përputhje me nenet e RRUOPP dhe si të tilla nuk paraqesin shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 41 të RRUOPP. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin e fundit ankimor që ka të bëjë me noterizimin e deklaratës mbi konfirmimetin e përshtatshmërisë dhe kualifikimeve Anex 3.A.4 ku pjesa e noterit nuk është e qartë saktësisht tek dokumenti identifikues i z. GuidoStefanelli (shtetas i Italisë) me nr. personal N.AV 243740 ku thuhet se

ky dokument është lëshuar nga MPB e Kosovës me datën 11.11.2016 në dokumentet e ofertës së konzorciumit të përgjegjshëm, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në fletën e lëshuar nga Noteri Sinan Visoka në Podujevë që ka noterizuar deklaratën mbi konfirmitetin e përshtatshmërisë dhe kualifikimeve Anex 3.A.4 për konzorciumin e shpallur të përgjegjshëm nga AK është fakt që shkruan nr. personal N.AV 243740 ku thuhet se ky dokument është lëshuar nga MPB e Kosovës me datën 11.11.2016 për z. GiudoStefanelli. Këtu shihet qartë se kemi të bëjmë me gabim teknik të lëshuar nga Noteri në fjalë. Megjithatë ai dokumenti i kërkuar nga AK është i noterizuar dhe e plotëson kërkesën e AK. Ky pretendim ankimor është i bazuar. Devijimi i tillë nuk e dëmton procesin prokurimit sepse është trajtuar si devijim i vogël nga autoriteti kontraktues i lejuar me dispozitat e pikës 4 të nenit 59 të LPP-së, devijim i cili nuk mundet të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat në njoftimin e kërkesës për kualifikim. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 65 të LPP-së dhe Ligjit nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, OE ankues nuk ka ofruar asnjë argument dhe as fakt për këto shkelje.

OE ankues në këtë aktivitet të prokurimit është shpallë i pa përgjegjshëm sepse nuk ka prezantuar tërë përmbajtjen obligative të projektit (të dokumentacionin teknik). Pika/fleta 07 e Detajeve karakteristike arkitektonike nuk është prezantuar fare.

Sipas komisionit vlerësues kjo pikë/fletë është esenciale për vlerësim pasi ka të bëjë me përshkrimin dhe paraqitjen grafike të afërt të përmbajtjeve të projektit (si p.sh. trupave ndriçues, llojet e drunjtëve (me vlerësim deri në 10% nga totali i pikëve), elementet mikro urbane si ulëset, rrigollat, pllakëzimin, etj...).

Më mungesë të kësaj pike/flete dhe përmbushjes obligative të përmbajtjes së projektit (dokumentacionit teknik) komisioni nuk ka vazhduar tutje me vlerësimin teknik të dokumentacionit të OE ankues.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i plotëson kërkesat e dokumentit tenderues (KPP) dhe njoftimit për kualifikim për pikat e kontestuara nga OE ankues.

Pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankues për shkelje të neneve të LPP-së, të theksuara në ankesë nuk qëndrojnë, përjashtimisht pretendimit për shkelje të nenit 43 të RRUOPP ku nuk është përdor formulari standard për eliminim por njoftimi është bërë me e-mail dhe pikës për gabimin e noterit që e sqaruam më lartë. Devijime të tilla janë të vogla dhe të lejuara me LPP. Nga kjo që u tha më lartë në përgjigjeje të pretendimeve ankimore, eksperti shqyrtuese vlerëson ankesën e OE ankues si pjesërisht të bazuar por këto devijime nuk e ndalojnë procesin për të vazhduar më tutje. Në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që vazhdojë me aktivitetin “Kërkesë për Propozim për PPP për Parkingun Nëntokësor në Prishtinë” me nr.prokurimi616-18-072-512 në bazë të dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 11.04.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr''Alba Clean'', përmes parashtresës me shkrim të datës:13.04.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24.04.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi operatorit ekonomik ankues, përfaqësuesja e autoritetit kontraktues eksperti shqyrtues profesional i prokurimit, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Nuha deklaroi: Pas udhëheqjes se një procedure të prokurimit nga AK duke u bazuar në ligjin e LPP-së, këtë procedure e kanë përcjell disa paqartësi që nga fillimi edhe gjatë fazës së sqarimeve kemi kërkuar sqarime shtese si dhe kemi kërkuar të ndryshohet metoda e vlerësimit sepse kjo metode që është përzgjedh nga AK do të rezultojë me diskriminim të padrejtë të ndonjë OE, procedurat kanë vazhduar me teje janë përgatite ofertimet edhe me dt 07.03.2019, kemi marr njoftimin përmes e-mailit nga AK që shkruan që ne jemi të diskualifikuar. Jemi të diskualifikuar me propozimin tuaj me keq ardhje ju njoftojmë se propozimi juaj nuk ka kaluar me arsye se kanë munguar detajet karakteristike arkitektonike pa u specifikuar cilat janë ato si rrjedhojë i këtyre mungesave komisioni nuk ka vazhduar me vlerësimin e ofertës. Në këtë rast nuk është përdorur letra standarde për njoftim B52. Mungojnë arsyet e eliminimit nuk janë të specifikuar arsyet e eliminimit. Ne kemi kërkuar sqarime të mëtejme për detajet e eliminimit të ofertës sonë AK përsëri bën shkeljen e njëjtë duke mos përdorur formularin standard sipas LPP-së, dhe prapë na dërgon një e-mail. Pas marrjes së këtyre e-mailave ku ne asnjërin prej tyre nuk paraqitet dëshmi për eliminimin e ofertës sonë ne kemi kërkuar qasje në dokumentet zyrtare. Me marrjen e dokumentacionit zyrtar është vërejtur se edhe në dokumentacionin të konzorciumit tjetër mungojnë detajet tjera të specifikuar dhe ne pretendojmë se është me pak i detajuar se projekti jone. Ne kemi bërë terkes për rishqyrtim të AK KK-Prishtine duke kërkuar për detajet teknike për secilën pjesë të projektit se ku janë detajet teknike të prezantuar në projektin tonë. Tek përshkrimi teknik dhe paraqitja grafike detajet arkitektonike të këtyre elementeve janë të përshkruara në ofertën teknike të konzorciumit tonë në fq. 15-16, në përshkrimin teknik të projektit. Duke precizuar saktësisht sasinë si dhe madhësinë e tyre, të njëjta elemente vrehen të prezantimet grafike. Si tonesi në

ketë pjese ne kemi paraparë te investohen 431.475. euro për deri sa konzorciumi tjetër parash te investoj 220.000 qe i bije qe ne kemi te investojmë 100%. Kjo është pika për të cilën ne jemi eliminuar nga AK-ja. Sa për njoftim investimet qe bëhen ne pjesën e Parkut janë investime te cilat nuk i sjellin përfitime konsocionarit realisht paraqesin një përparësi për përfituesit, parku është një pjese për qytetaret. Pika tjetër te pjesa e ekspertizës profesionale përgjigja brenda vlerësimit e pjesës teknike ka kundërshtime ne vete ku eksperti ne një pjese thotë qe nuk mund te shqyrtohet dhe ne te njëjtën pike thotë qe kjo pike është e pabazuar ne ketë pike qe jemi eliminuar eksperti ka thënë unë nuk mund ta shqyrtoj dhe kjo bien ne kundërshtim me vetveten duke nxjerr një konstatim si te pabazuar. Gjithashtu nuk pajtohem me konstatimin se përgjigja me e-mail nuk e dëmton procesin ne mendojmë qe procedurat standarde te prokurimit duhet aplikuar. Sipas eksperti mënyra e informimit përmes e-mailit nuk e ka dëmtuar procesin e prokurimit. Për ne ketë pike eksperti shqyrtues nuk e ka parasysh faktin se çdo dokument Standard ne procedurën e tenderimit duhet te përdorën ashtu siç kërkohen me Ligj. Kjo mund te shihet edhe tek KRPP-ja. Gjithashtu dëshirojmë ti dëshmojmë panelit qe AK ka përdor standarde te dyfishta nuk i ka trajtuar barabartë te gjithë OE ne ketë aktivitet ne pjesën ku është e zbrazet për çudi te tre anëtarët e komisionit kanë vlerësuar se i plotëson te gjitha kërkesat lidhur me OE tjetër qe e kanë shpallur te përgjegjshëm ku edhe ne hapësirat ku nuk ka shënuar asnjë kërkesë e AK-se, kanë vendosur shenjen qe plotësohen këto kritere, për derisa dy prej tyre i kanë bere nen kritere te reja ne formularin e vlerësimit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Isufi deklaroj: AK pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa për sa i përket njoftimit për tenderuesin e eliminuar ju njoftojmë se është njoftuar tenderuesi i eliminuar me e-mail zyrtar ne kohe dhe ne atë e-mail te gjitha te dhënat i ka përmbajtur përkatësisht arsyet e eliminimit te cilat do te duhej te paraqiten ne letrën për eliminim. Ne atë e-mail është cekur se komisioni i vlerësimit ka konstatuar se OE ankues nuk i ka plotësuar kriteret e dosjes dhe njoftimi ne ketë formë nuk AK ndikuar ne procesin e vlerësimit dhe kemi konstatuar si devijim i vogël. Komisioni i vlerësimit se OE "Nuha" i mungojnë detajet karakteristike arkitektonike detaj qe ka qen obligative qe të dorëzohet pra elementet mikro Urbane siç janë Ndriçimi Ulëset Krojet Fontaanat te cilat duhet te jen pjese përmbajtjesore të projektit sipas propozimit te kandidatit.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues/teknik z. Kurtishaj deklaroj: Bazuar në pretendimet ankimore të ngritura nga OE ankues unë kam dhen përgjigjet e mia të cilat janë të bazuara ne kërkesat e dosjes se tenderit faktet dhe argumente të ofruara nga OE ankues. Unë mbes në tërësi ne raportin e dhen në OSHP.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së z. Nuha deklaroj: Kërkojmë nga paneli qe te aprovohet ankesa jone dhe lënda të kthehet ne rivlerësim.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Isufi deklaroj :dhe kërkojmë qe te refuzohet ankesa dhe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-se.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional të prokurimit deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues pretendon se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së, paragrafi 1 kur ka eliminuar ofertën e tyre dhe tani ka mbete vetëm me një ofertë të përgjegjshme dhe nuk ka konkurrence të mirëfilltë financiare. Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor nuk qëndron për faktin se eliminimi i një oferte si të papërgjegjshme dhe mbetja e vetëm një oferte të përgjegjshme nuk është në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së. Sipas dispozitave të këtij neni, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Meqenëse në rastin e tanishëm oferta financiare nuk është hapur ende dhe nuk dihet sa është vlere, atëherë nuk dihet a është ekonomike apo jo. Prandaj deri në këtë fazë nuk ka shkelje të nenit 6 të LPP-së. Për krijimin e konkurrencës është e nevojshme në këtë procedurë numri i mjaftueshëm i ofertuesve, mirëpo ata gjithsesi duhet ti plotësojnë kushtet dhe kriteret e dokumentit tenderik për të kaluar këtë fazë. Nuk mundet të pranohet oferta e pa përgjegjshme vetëm për të krijuar konkurrencën.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, sepse ofertën e tyre nuk e ka trajtuar njëjtë si e konzorciumit tjetër konkurrent, ku të njëjtit i mungojnë mjaft detaje të tilla dhe është shpallë i papërgjegjshëm ne aspektin teknik , Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor nuk është i bazuar për faktin se eliminimi i operatorit ekonomik ankues është bërë për mos plotësim të një kërkesë obligative të dosjes së tenderit për dokumentacionin teknik të projektit. Sipas komisionit vlerësues, OE ankues nuk ka prezantuar fare dokumentet pjesa (d) Përmbajtja e projektit, respektivisht pika 7 e “Detajeve karakteristike arkitektonike”. Sipas pikës VI.3.2 Vlerësimi i propozimeve teknike të dokumentacionit tenderik thuhet: *“Komisioni i Vlerësimit rezervon të drejtën të refuzojë çdo propozim teknik i cili konsiderohet objektivisht të jetë i paarsyeshëm ose i pa-zbatueshëm. Propozimet teknike që konsiderohen të papranueshme, duke mos i plotësuar kushtet minimale teknike,do të refuzohen, pa shqyrtim të mëtejshëm. Propozimi financiar i*

ofertave që kanë dështuar për të marrë një rezultat kalues për Propozimin Teknik do të mbeten të mbyllura”.

Bazuar në këto dispozitat të dokumentit tenderues ekspertit profesional të prokurimit, vlerëson se komisioni i vlerësimit teknik të ofertave ka pasur të drejtë të eliminoj një ofertë që nuk i ka përmbushur kushtet minimale. Në rastin konkret eliminimi është bërë për shkak të mos plotësimit të pikës së theksuar më lartë “Detajeve karakteristike arkitektonike”. Pra nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues ka respektuar dispozitat e dhëna në dokumentin tenderues.

Vlerësimi i propozimeve teknike është bërë mbi bazën e kritereve të dhëna në dokumentin tenderues për të dy ofertuesit. Pretendimi i OE ankues se propozimit teknik të OE të përgjegjshëm i mungojnë mjaftë detaje (pa i përmendur cilat janë ato), nuk munden të shqyrtohen nga eksperti i prokurimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 54 të LPP-së, dhe nenit 43 të RrUOPP, sepse e ka njoftuar OE ankues për eliminim vetëm nëpërmjet emailit e jo me letër standarde për tenderuesit eliminuar. Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor është pjesërisht i bazuar për faktin se njoftimi i OE ankues për eliminim është bërë përmes e-mailit dhe jo me formularë standard të miratuar nga KRPP (B42). Si rregulle ky formularë duhet të përdoret nga autoritetet kontraktuese me rastin e njoftimit të tenderuesve. Megjithatë edhe informimi përmes e-mailit ka paraqitë arsyet e eliminimit të OE ankues. Kjo mënyrë e njoftimit të operatorit ekonomik ankues nuk e ka dëmtuar atë si edhe nuk ka ndikuar në procesin e prokurimit.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 72 të LPP-së, dhe nenit 39 të RrUOPP, sepse nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues por është eliminuar pa të drejtë nga AK, Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar për faktin se neni 72 pika 2 të LPP-së, thuhet se, autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësoj certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së.

Në rastin konkret autoriteti kontraktues e ka eliminuar operatorin ekonomik për detajet karakteristike arkitektonike të projektit të cilat nuk janë punuar sipas kërkesës të dokumentit tenderik. Pra pjesa e projektit për të cilën është eliminuar OE ankues nuk përfshihet në kuadër të dokumenteve të parapara në nenet 65-71 të LPP-së. Po ashtu kjo pjesë e projektit nuk mundet të plotësohet pas dorëzimit të ofertës sepse mbi ndesh me pikën 3 të nenit 72. Andaj nuk kemi të bëjmë shkelje të nenit 72 të LPP-së, siç pretendon OE ankues.

Sa i përket pretendimit të OE ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, dhe nenit 29, 41 dhe 27 të RrUOPP, sepse OE ankues ka ofruar sigurimin e tenderit me afat 125 ditë e që duhet të jetë 150 ditë, dhe njëheritë në emër të konzorciumit fitues ka nënshkruar i njëjti person z. Guido Stefanelli, dokumentet në emër të dy kompanive që janë pjesë e këtij konzorciumi . Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor është i pabazuar për faktin se në dokumentin tenderues KPP pika IV.7 Sigurimi i tenderit ceket: *“Ofertuesi do të kërkohet që të vendosë sigurimin e parevokueshëm dhe pa kushte të tenderit në shumën prej 200,000.00 € (dyqind mijë Euro) ("Sigurimi i Tenderit") për kohëzgjatjen e periudhës së vlefshmërisë të tenderit, siç është përcaktuar në nenin IV.11 të këtij dokumenti”*. Gjithashtu kjo është sqaruar edhe në sqarimet shtesë #4 të AK-së. Po ashtu pjesë e dokumentit tenderues (KPP) është edhe Formulari 3.A.2 – Formulari i Sigurimit të Tenderit cili në një dispozitë të tije thotë: *“Kjo garanci është në fuqi nga data e këtij ligji dhe do të mbeten në fuqi të plotë deri në skadimin e periudhës së vlefshmërisë së ofertës”*

Mbi bazën e kërkesës për sigurimin e tenderit të dhënë nga autoriteti kontraktues në dokumentin tenderues (KPP), atëherë edhe konzorciumi i shpallur si i përgjegjshëm e ka ofruar sigurimin e ofertës në përputhje me kërkesën, respektivisht 5 ditë më të gjatë se kërkesa. Prandaj kjo është në rregulle sepse kërkesa e autoritetit kontraktues ka qenë e tillë. Sa i përket pjesës tjetër të këtij pretendimi se personi i njëjtë ka nënshkruar dokumentet për të dy kompanitë të cilat janë pjesë e një konzorciumi, kjo nuk bënë shkelje të LPP-së, sepse të dy kompanitë kanë dorëzuar një ofertë në emër të një konzorciumi. Personi në fjalë, nënshkruar i dokumenteve është përfaqësues zyrtar i dy kompanive. Po ashtu kompanitë kanë nënshkruar deklaratat për marrje pjesë në këtë konzorcium në përputhje me nenin 27 të RRUOPP. Të gjitha këto pjesë, të këtij pretendimi ankimor janë në përputhje me nenet e RRUOPP dhe si të tilla nuk paraqesin shkelje të nenit 59 të LPP-së, dhe nenit 41 të RRUOPP.

Sa i përket pretendimit të OE ankues e që ka të bëjë me noterizimin e deklaratës mbi konfirmimetin e përshtatshmërisë dhe kualifikimeve Anex 3.A.4 ku OE ankues pretendon se pjesa noterit nuk është e qartë saktësisht tek dokumenti identifikues i z. GuidoStefanelli (shtetas i Italisë) me nr. personal N.AV 243740, në të cilin thuhet se ky dokument është lëshuar nga MPB e Kosovës me datën:11.11.2016, në dokumentet e ofertës së konzorciumit të përgjegjshëm, Paneli shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se ky pretendim ankimor është i bazuar për faktin se në fletën e lëshuar nga Noteri z.Sinan Visoka në Podujevë, që ka noterizuar deklaratën mbi konfirmimetin e përshtatshmërisë dhe kualifikimeve Anex 3.A.4 për konzorciumin e shpallur të përgjegjshëm nga AK është fakt që shkruan nr. personal N.AV 243740 ku thuhet se ky dokument është lëshuar nga MPB e Kosovës me datën 11.11.2016, për z. Guido

Stefanelli. Këtu shihet qartë se kemi të bëjmë me gabim teknik të lëshuar nga Noteri në fjalë. Megjithatë ai dokumenti i kërkuar nga autoriteti kontraktues është i noterizuar dhe e plotëson kërkesën e AK.

Devijimi i tillë nuk e dëmton procesin e prokurimit sepse është trajtuar si devijim i vogël nga autoriteti kontraktues i lejuar me dispozitat e pikës 4 të nenit 59 të LPP-së, devijim i cili nuk mundet të shkaktoj ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat në njoftimin e kërkesës për kualifikim.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, konstaton sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 65 të LPP-së dhe Ligjit nr.04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, OE ankues nuk ka ofruar asnjë argument dhe as një fakt për këto shkelje.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, konstaton se grupi i operatoreve ekonomik konzorciumi Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr''Alba Clean'' –me seli në Gjermani, në këtë aktivitet të prokurimit është shpallë i pa përgjegjshëm sepse nuk ka prezantuar tërë përmbajtjen obligative të projektit (të dokumentacionin teknik). Pika/fleta 07 e Detajeve karakteristike arkitektonike nuk është prezantuar fare. Sipas komisionit vlerësues kjo pikë/fletë është esenciale për vlerësim pasi ka të bëjë me përshkrimin dhe paraqitjen grafike të afërt të përmbajtjeve të projektit (si p.sh. trupave ndriçues, llojet e drunjtëve (me vlerësim deri në 10% nga totali i pikëve), elementet mikro urbane si ulëset, rrigollat, pllakëzimin, etj...).

Më mungesë të kësaj pike/flete dhe përmbushjes obligative të përmbajtjes së projektit (dokumentacionit teknik) komisioni nuk ka vazhduar tutje me vlerësimin teknik të dokumentacionit të OE ankues. Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë 'Passina Construsion S.P.A & Jaha Company sh.p.k. Pesina Gestoni S.R.L –Itali/Prishtinë, i plotëson kërkesat e dokumentit tenderues (KPP) dhe njoftimit për kualifikimin për pikat e kontestuara nga OE ankues.

Paneli shqyrtues me lart i dha konstatimet lidhur me pretendime ankimore, por Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion si dhe në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit konstaton se autoriteti kontraktues, nuk ka vepruar në harmoni me nenin 49.13 Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, për faktin se në fazën të cilën është kjo procedurë e prokurimit neni i cekur më lartë e shtjellon shumë çart fazën të cilën gjendet autoriteti kontraktues në këtë rast Kuvendi i Komunës Prishtinë, andaj në nenin 49.13 thuhet: *49.13 Ligji i PP përcakton numrin maksimal të OE të cilët duhet të ftohen në fazën e dytë POR nuk përcakton numrin minimal të OE të cilët duhet të ftohen në fazën e dytë, megjithatë gjithmonë ceket fjala "Operatorët e zgjedhur Ekonomik" ose*

“Kandidatet” qe do te thote se ne fazen e dyte duhet te ketë me shume se një OE ne mënyre qe Autoriteti Kontraktues te ketë konkurrenca ne fazen e dyte. Nisur nga fakti se ne Direktivat e BE-se për prokurimin publik numri minimal i OE ne procedurën e kufizuar është i përcaktuar ne 5 (pese), dhe duke u bazuar ne praktikat me te mira ndërkombëtare dhe ne mënyre qe te sigurohet konkurrenca dhe transparencja adekuate, AK nuk duhet te vazhdoj me fazen e dytë nëse ka pranuar me pak se 3 (tri) aplikacione te përgjegjshme. Andaj autoriteti kontraktues Kuvendi i Komunës Prishtinë, duhet ti ketë parasysh dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe RrUOPP-se ne fuqi.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesë padi mund t’i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim Dina



Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – Kuvendi i Komunës Prishtinë

1x1 OE- N.T. Nuha Bauunternehmung GMBH & Co, KG& Qamili Gbr’’Alba Clean’’ –me seli në Gjermani

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.